

V E N D I M
Nr. 76, datë 6.2.2003

**PËR NIVELET E PAGAVE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË ENTIT
RREGULLATOR TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës” dhe të nenit 85 të ligjit nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Niveli i pagave të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve të jetë si më poshtë:

a) Paga e Kryetarit të Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve të përcaktohet, sipas kategorisë I-a, të klasës I, të lidhjeve nr.I dhe nr.II, të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

b) Paga e anëtarit të Këshillit Drejtues të njehsohet me pagën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas kategorisë II-a të klasës II të lidhjeve nr.1 dhe nr.2, të vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

2. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagesat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të bëhen këto ndryshime:

a) Në lidhjen I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, në klasifikimin A12, emërtimi “Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”, shfuqizohet.

b) Në lidhjen II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore” shfuqizohen këto emërtime:

- Në klasifikimin A12 “Kryetar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”;

- Në klasifikimin B2 “Anëtar i Këshillit Drejtues të Entit Rregullator të Telekomunikacioneve”.

3. Në vendimin nr.390, datë 24.6.1998 të Këshillit të Ministrave, pikat 2a, 2b dhe 2c shfuqizohen.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Entit Rregullator të Telekomunikacioneve.

5. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Enti Rregullator i Telekomunikacioneve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano